**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**
**DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TATIMPAGUESIT E MEDHENJ**
**Drejtoria e Vleresimit te te Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit**

**Adresa:"Presidenti George W. Bush", Tel/Fax: 270974; Tel 270975,270972,270973**

**Nr.** 6147 **Prot.** **Tirane, me** 02 / 05 **/2013**

**Lenda : Dergim pasqyra financiare**

**Per shoqerine : G.P.G Company**
Adresa: Lagjja 18 Tetori

**LUSHNJE**

Ne pergjigje tuajes nr ska prot date 01.05.2013, me objekt konfirmim pasqyrash financiare, bashkangjitur po ju percjellim te njesuar me origjinalin, pasqyrat financiare te shoqerise tuaj per vitin 2012 , depozituar prane drejtorise tone me nr 519 date 29.03.2013

**DREJTORI**

**DEFRIM MANOKU**

# "G P G COMPANY" SHPK

518
28.03.2013

**Forma juridike: SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**Data e themelimit: 12.01.1996**

**Numri unik i indentifikimit(NIPT): J 64324443 V**
**Selia: LAGJA 18-Tetori, LUSHNJE**

**Objekti tregtar: SHERBIME NE FUSHEN E NDERTIMEVE**

# Pasqyrat Financiare Vjetore 2012

**(Mbyllur më 31.12.2012)**

NJJESOHET ME ORIGJINALIN
DREJTORI
(DEFRIM [illegible])

**Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)**

**Periudha kontabel: Nga 01.01.2012 deri më 31.12.2012**

**Data e mbylljes: 20 Mars 2013**

**Monedha: Leke**

**Shkalla e rrumbullakimit: ne leke**

**Lushnje, Mars 2013**

# Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR ..... 0

B. BILANCI KONTABEL ..... 2

C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE ..... 3

D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE ..... 4

E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA ..... 5

F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE ..... 6-15

## BILANCI KONTABEL
### Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| A AKTIVI | Shenimi nr. | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012 | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2011 |
|---|---|---|---|
| **I AKTIVET AFATSHKURTRA** | | | |
| **1 Aktive monetare** | 3 | **16,498,707** | **959,435** |
| 2 Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim | | - | - |
| (i) Derivativët | | - | - |
| (ii) Aktivet e mbajtura për tregtim | | - | - |
| **Totali 2** | | **16,498,707** | **959,435** |
| 3 Aktive të tjera financiare afatshkurtra | 4 | | |
| (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme | | 1,735,243,493 | 1,368,587,406 |
| (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme | | - | 148,732 |
| (iii) Instrumente të tjera borxhi | | 5,545,234 | 5,545,234 |
| (iv) Investime të tjera financiare | | 112,200,840 | 126,183,394 |
| **Totali 3** | | **1,852,989,567** | **1,500,464,766** |
| 4 Inventari | 5 | | |
| (i) Lëndët e para | | 42,572,703 | 40,370,264 |
| (ii) Prodhim në proces | | - | - |
| (iii) Produkte të gatshme | | - | - |
| (iv) Mallra për rishitje | | - | - |
| (v) Parapagesat për furnizime | | 0 | 0 |
| **Totali 4** | | **42,572,703** | **40,370,264** |
| 5 Aktivet biologjike afatshkurtra | | - | |
| 6 Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje | | | |
| 7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | | | |
| **TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)** | | **1,912,060,977** | **1,541,794,465** |
| **II AKTIVET AFATGJATA** | | | |
| 1 Investimet financiare afatgjata | | | |
| (i) Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm në PF) | | - | - |
| (ii) Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje | | - | - |
| (iii) Aksione dhe letra të tjera me vlerë | | - | - |
| (iv) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata | | - | - |
| **Totali 1.** | | - | - |
| **2 Aktive afatgjata materiale** | 6 | | |
| (i) Toka | | 8,894,000 | 8,894,000 |
| (ii) Ndërtesa | | 5,154,978 | 5,426,293 |
| (iii) Makineri dhe pajisje | | 108,336,894 | 111,365,201 |
| (iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.) | | 33,210,750 | 36,917,010 |
| **Totali 2** | | **155,596,622** | **162,602,504** |
| 3 Aktivet Biologjike afatgjata | | - | - |
| 4 Aktivet afatgjata jomateriale | | | |
| (i) Emri i mirë | | - | - |
| (ii) Shpenzimet e zhvillimit | | - | - |
| (iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale | | - | - |
| **Totali 4** | | **0** | |
| 5 Kapital aksionar i papaguar | | 0 | 0 |
| 6 Aktive të tjera afatgjata | | | 0 |
| **TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)** | | **155,596,622** | **162,602,504** |
| **TOTALI I AKTIVEVE (I + II)** | | **2,067,657,599** | **1,704,396,969** |

Shenimet shoqeruese nga1 deri ne 15 jane pjese perperse e ketyre pasqyrave financiare



DREJTORI
DEFRIM MANOKI

| B | PASIVI | Shënime | Viti raportues 31.12.2012 | Viti paraardhës 31.12.2011 |
|---|---|---|---|---|
| | **DETYRIMET DHE KAPITALI** | | | |
| I | **DETYRIMET AFATSHKURTRA** | | | |
| 1 | **Derivativët** | | - | - |
| 2 | **Huamarrjet** | 7 | | - |
| | (i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra | | 94,968,272 | 94,392,105 |
| | (ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata | | | - |
| | (iii) Bono të konvertueshme | | - | - |
| | **Totali 2** | | **94,968,272** | **94,392,105** |
| 3 | **Huatë dhe parapagimet** | 8 | | |
| | (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve | | 1,242,982,122 | 1,124,307,390 |
| | (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve | | 10,032,927 | 3,439,307 |
| | (iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | | 15,132,747 | 2,440,594 |
| | (iv) Hua të tjera | | - | - |
| | (v) Parapagimet e arkëtuara | | 75,087,071 | 74,384,280 |
| | **Totali 3** | | **1,343,234,867** | **1,204,571,571** |
| 4 | Grantet dhe të ardhurat e shtyra | | - | - |
| 5 | Provizionet afatshkurtra | | - | - |
| | **TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)** | | **1,438,203,139** | **1,298,963,676** |
| II | **DETYRIME AFATGJATA** | | | |
| 1 | **Huatë afatgjata** | 9 | | |
| | (i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare | | 199,368,589 | 39,368,589 |
| | (ii) Bonot e konvertueshme | | - | - |
| | **Totali 1** | | **199,368,589** | **39,368,589** |
| 2 | Huamarrje të tjera afatgjata | | - | |
| 3 | Provizionet afatgjata | | - | - |
| 4 | Grantet dhe të ardhurat e shtyra | | - | - |
| | | | - | - |
| | **TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)** | | **199,368,589** | **39,368,589** |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE** | | | |
| III | **KAPITALI** | 10 | | |
| 1 | Aksionet e pakicës ( përdoret vetëm në pasqyrat | | - | - |
| 2 | Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mër | | - | - |
| 3 | Kapitali i rregjistruar(aksionar) | | 290,000,000 | 290,000,000 |
| 4 | Primi i aksionit | | - | - |
| 5 | Njësitë ose aksionet e thesarit (negative) | | - | - |
| 6 | Rezerva statutore | | - | - |
| 7 | Rezerva ligjore | 10 | 76,064,704 | 21,679,248 |
| 8 | Rezerva të tjera | 10 | | - |
| 9 | Fitimet(humbja) e pashpërndara | | | - |
| 10 | Fitimi (humbja) e vitit financiar | 11 | 64,021,167 | 54,385,456 |
| | **TOTALI I KAPITALIT (III)** | | **430,085,871** | **366,064,704** |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III)** | | **2,067,657,599** | **1,704,396,969** |

DREJTORI
DEFRIM MANOKLI

## PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë)**

| | | Shenimi nr. | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012 | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2011 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shitjet neto | 11 | 864,364,897 | 1,098,755,994 |
| 2 | Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Pu | . | 200,000 | 833,333 |
| 3 | Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dl | . | - | - |
| 4 | Materialet dhe mallrat e konsumuara | 11 | (583,214,157) | (783,599,193) |
| 5 | Kosto e punës | 11 | - | |
| | Pagat e personelit | | (24,169,280) | (23,927,554) |
| | Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore | | (3,915,203) | (3,867,445) |
| 6 | Amortizimet dhe zhvlerësimet | | (23,409,098) | (19,668,889) |
| 7 | Shpenzime të tjera | | (148,806,104) | (191,435,780) |
| 8 | **Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)** | | **(783,513,842)** | **(1,022,498,861)** |
| 9 | **Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+** | 0 | **81,051,055** | **77,090,466** |
| 10 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara | | - | - |
| 11 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet | | - | - |
| 12 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare | 11 | - | - |
| | 12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata | | - | - |
| | 12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667 | | (9,125,103) | (16,593,450) |
| | 12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669 | | (149,031) | 309,069 |
| | 12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668 | | - | - |
| 13 | **Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare** | | (9,274,134) | (16,284,381) |
| 14 | **Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)** | 0 | **71,776,921** | **60,806,085** |
| 15 | **Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69** | 12 | **7,755,754** | **6,420,629** |
| 16 | **Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)** | 11 | **64,021,167** | **54,385,456** |
| 17 | **Elementët e pasqyrave të konsoliduara** | | - | - |

DREJTORI
DEFRIM MANOKU

## PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE (cash flow)
### Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011
(Të gjitha balancat janë në lekë)

| | Shenimi nr. | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012 | Ushtrimi i mbyllur 31.12.2011 |
|---|---|---|---|
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | | | |
| Fitimi para tatimit | | 71,776,921 | 60,806,085 |
| Rregullime për: | | | |
| Amortizimin | | 23,409,098 | 19,668,889 |
| Humbje nga këmbimet valutore | | - | - |
| Të ardhura nga investimet | | - | - |
| Shpenzime për interesa | | 9,125,103 | 16,593,450 |
| Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivit | | (356,875,152) | (341,078,357) |
| Rritje/rënie në tepricën inventarit | | (2,202,439) | (14,530,586) |
| Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti | | 139,239,463 | 296,573,630 |
| Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet | | (115,527,006) | 38,033,111 |
| Interesi i paguar | | (9,125,103) | (16,593,450) |
| Tatim mbi fitimin i paguar | | (3,405,403) | (6,610,021) |
| **Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit** | | **(128,057,512)** | **14,829,640** |
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese** | | | |
| Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara | | - | - |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | | (16,901,667) | (33,239,362) |
| Të ardhura nga shitja e pajisjeve | | 498,451 | 577,795 |
| Interesi i arkëtuar | | - | - |
| Dividendët e arkëtuar | | - | |
| **Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese** | | (16,403,216) | (32,661,567) |
| Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare | | | |
| Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner | | - | - |
| Hyrje nga huamarrje afatgjata | | 160,000,000 | - |
| Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare | | - | - |
| Dividendët e paguar | | - | - |
| **Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare** | | 160,000,000 | - |
| **Rritja/rënia neto e mjeteve monetare** | | **15,539,272** | **(17,831,927)** |
| **Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël** | | **959,435** | **18,791,362** |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël** | | **16,498,707** | **959,435** |

DREJTORI
DEFRIM MANOKU

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë)**

| | Kapitali i rregjistruar (aksionar) | Primi i aksionit | Rezerva ligjore statusore | Fitimi pashpërndarë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2010** | 220,000,000 | - | 12,424,981 | 79,254,267 | 311,679,248 |
| Efekti ndryshimeve ne politikat kontabë | - | - | | - | - |
| **Pozicioni I rregulluar** | 220,000,000 | - | 12,424,981 | 79,254,267 | 311,679,248 |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | | 54,385,456 | 54,385,456 |
| Dividentët e paguar | | | - | | - |
| Rritje e rezervës së kapitalit | - | | 9,254,267 | (9,254,267) | - |
| Emetimi i kuotave(aksioneve) | 70,000,000 | - | | (70,000,000) | - |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2011** | 290,000,000 | - | 21,679,248 | 54,385,456 | 366,064,704 |
| | | | | | - |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | - | - | | 64,021,167 | 64,021,167 |
| Dividentët e paguar | - | - | | - | - |
| Emetim i kapitalit aksionar | - | - | | - | - |
| Rritje e rezervës së kapitalit | | | 54,385,456 | (54,385,456) | - |
| Aksione te thesarit te riblera | - | - | - | - | - |
| | | | | | - |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2012** | **290,000,000** | **-** | **76,064,704** | **64,021,167** | **430,085,871** |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i " G.P.G Company " shpk dhe jane firmosur nga:

Hartuesi

**Olsa ZIU**

Administratori

**Pagsor BUZI**

Lushnje , me 20.03.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISE Import&Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J61324443V LUSHNJE ALBANIA

DREJTORI (DEFRIM MANOKU)

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

## 1. TE PERGJITHSHME

HISTORIA DHE KRIJIMI

"G.P.G Company " shpk , eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 10 Korrik 1996 me vendim nr.15432 te me ortak z. Gezim DANI dhe z.Gezim KOCIU te cilet zoteronin nga 50 % te kuatave te kapitalit themeltar . Me vendim nr.15432/5 date 19.03.2007 eshte bere shitja e kuotave te kapitalit z. Paqsor BUZI I cili zoteron 100% te kapitalit themeltar . Gjate ushtrimit 2011 ka ndodhur ndryshim ne madhesin e kapitalit I cili eshte zmadhuar . Kapitali I rregjistruar aktualisht eshte **290.000.000** leke dhe zoterohet teresisht nga ortaku I vetem z. Paqsor BUZI .

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne leke Shqiptare ( Leke ) meqense kjo eshte monedha ne te cilen jane kryer pjesa me e madhe e transaksioneve te Shoqerise .

AKTIVITET KRYESOR

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2012 jane sherbimet ne fushen e ndertimit..

DREJTUESIT

BORDI DREJTUES

| EMRI | FUNKSIONI | VENDI |
|---|---|---|
| Paqsor BUZI | Administrator | Lushnje |

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

**Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit ( S.K.K ) .
Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara.
Pasqyrat financiare te shoqerise pergatiten cdo vit me 31 Dhjetor .

***Nje permbledhje e politikave kryesore kontabel eshte paraqitur me poshte:***

**Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve.
Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe te ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

**Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2012 jane :

EURO : LEK 139.59

USD : LEK 105.85

**Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes perfshijne interesin e paradhenieve bankare dhe huave afatshkurtera dhe afatgjata . Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim ne periudhen qe ato jane shkaktuar pavarsisht se si huate jane aplikuar .

**Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem per vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai perjashton zera te te ardhurave dhe shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjere dhe gjithashtu perjashton zera qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem . Detyrimi i shoqerise per tatim fitimin e vitit llogaritet duke perdorur normat e tatimit te percaktuara nga legjislacioni shqiptar per kontabilitetin ne Shqiperi . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin eshte 10 % .

**Instrumentet financiar**

Mjetet dhe detyrimet financiare njihen ne bilancin kontabel te shoqerise kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktore per instrumentin .

**Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Detyrimet financiare**

Detyrimet financiare jane klasifikuar sipas llojit te marrveshjes kontraktuale
Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Risku I kreditimit**

Risku I kreditimit te Shoqerise kryesisht I vishet kerkesave per arketim dhe aktiveve te tjera te saj . Gjendjet e paraqitura ne bilancin kontabel jane zvogeluar nga provigjonet (shumat e parashikuara ) per kerkesat e dyshimta per arketim , te vleresuara nga drejtimi I shoqerise mbi bazen e experiences se meparshme dhe vleresimit te mjedisit ekonomik aktual .
Shoqeria nuk ka perqendrim te rendesishem te riskut te kreditimit , me nje zbulim te shperndare ne nje numur te madh te tretesh dhe klientesh .

**Aktivet afatgjata materiale ( AAM-te )**

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten me shuma te rivleresuara minus zhvleresimin . Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve afatgjata materiale , duke ngarkuar pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**Inventaret**

Inventaret jane paraqitur me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme .
Kosto perbehet nga materiale direkte dhe , ne rastet kur eshte e aplikueshme , kostot e punes direkte dhe ato kosto te pergjithshme qe jane ndeshur per te sjelle inventare ne vendin dhe kushte aktuale magazinimi . Kosto eshte llogaritur duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar .
Vlera neto e realizueshme perfaqson cmimin e vleresuar te shitjes minus kostot e vleresuara te perfundimit dhe kostot e marketingut , shitjes dhe shperndarjes .
Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

## 3. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011 jane si me poshte:

| Emertimi i Llogarise | Monedha | Gjendja ne 31.12.2012 | | Gjendja ne 31.12.2011 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ne leke | Ne valute | Ne leke | Ne valute |
| Llogari bankare | LEK | 16,498,707 | - | 959,435 | - |
| Arka ne leke | LEK | 0 | - | 0 | - |
| Shuma | | 16,498,707 | x | 959,435 | x |

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane konvertuar ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

## 4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 deklarohen si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| Aktive të tjera financiare afatshkurtra | | |
| (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme | 1,735,243,493 | 1,368,587,406 |
| (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme 467+444 | 5,545,234 | 5,693,966 |
| (iii) Instrumente të tjera borxhi | | |
| (iv) Investime të tjera financiare | | |
| (v)shpenzime te shtyra | 112,200,840 | 126,183,394 |
| Shuma | **1,852,989,567** | **1,500,464,766** |

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " ne shumen leke jane pasqyruar vlerat e akumuluara te situacioneve te ndertimit (faturave) te apartamenteve qe shoqeria nderton per shitje me fondet e veta kerkesa te arketueshme ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe sherbimeve.
Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne llog 467 Debitor te tjere kreditore te tjere dhe perfaqeson marredheniet e shoqerise qe ka me debitore te tjere (individ e shoqeri)per marredhenie financiare te perkohshme.
Ne shpenzimet e shtyra per 112.200.840 leke perfaqeson: shuma 1.281.604 leke jane pagesat per shpenzime te cilat i perkasin viteve te ardheshme ushtrimore, shuma prej 110.919.236 leke perfaqeson marrdheniet e shoqerise me parapagimet per furnitoret.
Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

## 5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| **Inventari** | | |
| (i) Lëndët e para | 42,572,703 | 40,370,264 |
| (ii) Prodhim në proces | - | - |
| (iii) Produkte të gatshme | - | - |
| (iv) Mallra për rishitje | | - |
| (v) Parapagesat për furnizime | - | - |
| (vi)Inventar I imet ne perdorim | | - |
| Shuma | **42,572,703** | **40,370,264** |

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2012. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te ndermjetem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda "FIFO". Shuma e inventarit te paraqitur ne " Lëndët e para" perfaqson stokun e materialeve qe perdoren ne procesin e ndertimit, ndersa "Mallra për rishitje" perbehen nga mallra ne rrjetin e shitjes, te vleresuara me kostot e blerjes te fundit te ushtrimit .
Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

## 6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

| | Gjendjet dhe levizjet | Toka | Ndertesa | Makineri dhe paisje | Aktivet te tjera afatgjata materiale | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| A | Kosto e AAM-ve me 01.01.2012 | 8,894,000 | 7,623,810 | 189,398,912 | 67,410,285 | 273,327,007 |
| | Shtesat | - | - | 14,279,639 | 2,622,028 | 16,901,667 |
| | Pakesimet | - | - | 0 | (1,131,246) | (1,131,246) |
| | Kosto e AAM-ve 31.12.2012 | **8,894,000** | **7,623,810** | **203,678,551** | **68,901,067** | **289,097,428** |
| | | | | | | |
| B | Amortizimi AAM-ve 01.01.2012 | - | 2,197,517 | 78,033,711 | 30,493,275 | 110,724,503 |
| | Amortizimi ushtrimit | | 271,315 | 17,307,946 | 5,829,837 | 23,409,098 |
| | Amortizimi per daljet e AAM-ve | - | - | 0 | (632,795) | (632,795) |
| | Amortizimi i AAM-ve 31.12.2012 | - | **2,468,832** | **95,341,657** | **35,690,317** | **133,500,806** |
| | | | | | | 0 |
| C | Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2012 | - | - | 0 | 0 | 0 |
| | Shtesat | - | - | 0 | 0 | 0 |
| | Pakesimet | - | - | 0 | 0 | 0 |
| | Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2012 | - | - | - | - | - |
| | | | | | | |
| D | Vlera neto e AAM-ve 01.01.2012 | 8,894,000 | 5,426,293 | 111,365,201 | 36,917,010 | 162,602,504 |
| | | | | | | 0 |
| | **Vlera neto e AAM-ve 31.12.2012** | **8,894,000** | **5,154,978** | **108,336,894** | **33,210,750** | **155,596,622** |

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2012.Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.
Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.
Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane te njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2)Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

## 7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| Huamarrjet | | |
| (i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra | 94,968,272 | 94,392,105 |
| (ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata | | 0 |
| (iii) Bono të konvertueshme | 0 | 0 |
| Shuma | 94,968,272 | 94,392,105 |

"Kthimet / ripagesat e huave afadhkurtra" perfaqeson kestet e kredise afatshkurtera qe do paguhen brenda 12 muajve te ardhshem te marre nga " Banka Nderkombetare e Greqise"(NBG) ne shumen respektive me 31.12.2012 jane ; 69.316.653 leke. Gjendja e huase bankare eshte rivleresuar me 31.12.2012 me kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise dhe diferencat kane kaluar ne rezultat .
Shoqeria ka marre nje hua bankare ne forme overdrafti nga Raiffeisen Bank ne leke ne shumen 25.651.619 e cila eshte gjendje me 31.12.2012 dhe rakordon me ekstraktin e bankes.



G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443 LUSHNJE

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

## 8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| Huate dhe parapagimet | | |
| (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve | 1,242,982,122 | 1,124,307,390 |
| (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve | 10,032,927 | 3,439,307 |
| (iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | 15,132,747 | 2,440,594 |
| (iv) Hua të tjera | 0 | 0 |
| (v) Parapagimet e arkëtuara | 75,087,071 | 74,384,280 |
| Shuma | **1,343,234,867** | **1,204,571,571** |

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit.Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.
"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per tatimin mbi vleren e shtuar ne shumen 10.288.443 leke, tatimit mbi te ardhurat personale ne shumen 124.600 leke dhe per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2012 ne shumen 518.085 leke, tatim fitim 4.201.619 leke.
"Parapagimet e arkëtuara" perfaqesojne arketimet e pronotuesve te apartamenteve te banimit, ne baze te kontratave te porosise, per te cilet nuk eshte realizuar kontrata e shitjes dhe trasferimi i titullit te pronesie.

## 9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| Huatë afatgjata | | |
| (i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare | 199,368,589 | 39,368,589 |
| (ii) Bonot e konvertueshme | 0 | 0 |
| Shuma | 199,368,589 | 39,368,589 |

"Hua ,bono e detyrime nga qeraja financiare" perbehet nga kontributi i derdhur nga ortaku per mbulimin e mungeses se likujditeteve dhe hua te marre nga shoqeria.

## 10. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Ne vitin 2010 ai eshte 220.000.000 leke, i ndare ne 220.000 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel 2011 ka rritje ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise por jo ne raportet zoterimit nga ortaket. Kapiatli I shoqerise nga 220.000.000 leke eshte zmadhuar ne 290.000.000 leke .Gjate viti 2012 nuk kane ndodhur ndryshime ne kapitalin e shoqerise.

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import&Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J61904403V LUSHNJE ALBANIA

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

## 11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- **Te ardhurat**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| **Te ardhurat** | | |
| Te ardhurat nga shitja e produkteve | 30,284,353 | 191,357,584 |
| Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve | 829,769,654 | 900,150,842 |
| Te ardhurat nga shitja e mallrave | 4,310,890 | 7,247,567 |
| Te ardhurat te tjera(AAM) | 200,000 | 833,333 |
| Shuma | 864,564,897 | 1,099,589,326 |

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.Të ardhurat nga sherbimet e ndertimit ne apartamente banimi, jane njohur deri në masën e shpenzimeve të rikuperueshme, të njohura në kontabilitet.(Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNK-8).Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| Të ardhurat nga interesat 767, 667(+) | | |
| Shpenzimet per interesat 767, 668(-) | (9,125,103) | (16,593,450) |
| Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+) | (149,031) | 309,069 |
| Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-) | - | - |
| Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668 | - | - |
| Shuma | (9,274,134) | (16,284,381) |

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2012 jane treguar ne pasqyren perkatese.

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import&Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J[illegible]24443V LUSHNJE ALBANIA

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**

**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| **Furnitura** | | |
| a-Sherbime nga te tretet ( nenkontraktor ) 611 | 118,957,035 | 156,704,262 |
| b-energji avull uje) | 1,295,290 | 2,433,893 |
| c-Mirmbajtje dhe riparime ( 615 ) | 9,202,128 | 13,393,649 |
| d-Sigurime ( 616 ) | 1,254,160 | 1,380,287 |
| e-Kerkime dhe studime ( 617 ) | 0 | 0 |
| f-Te tjera ( 618 ) | 4,578,780 | 6,401,984 |
| j-Shpenzime per koncesione , patent ( 623) | 0 | 0 |
| m-Shpenzime postare dhe telekomunikacioni (626 ) | 999,460 | 1,667,852 |
| n-Shpenzime transporti ( 627 ) | 0 | 85,260 |
| o-Sherbime bankare ( 628 ) | 652,854 | 421,787 |
| p-Tatime dhe taksa ( 632-638 ) | 5,587,323 | 3,784,409 |
| q-Vlera kontabel e AAM te shitura ( 652 ) | 498,453 | 577,795 |
| r-Shpenzime pritje dhe perfaqsimi ( 654 ) | 0 | 1,184,400 |
| t-Gjoba dhe demshperblime ( 657 ) | 5,780,621 | 3,400,202 |
| **Shuma** | **148,806,104** | **191,435,780** |

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

- **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

| Kategorite | Ushtrimi 2012 (000 leke) | | | Ushtrimi 2011 (000 leke) | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numer mesatar | Paga | Sgurime punedhenesi | Numer mesatar | Paga | Sgurime punedhenesi |
| Administrator, menaxher | 1 | 1,800 | 179 | 1 | 1,800 | 301 |
| Specialist me arsim universitar | 10 | 5,179 | 865 | 8 | 4,800 | 802 |
| Teknike | 3 | 982 | 164 | 2 | 720 | 120 |
| Puntore | 60 | 16,208 | 2,707 | 62 | 15,838 | 2,645 |
| **Shuma** | **74** | **24,169** | **3,915** | **73** | **23,158** | **3,867** |

## 12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2012 dhe 2011 jane si vijon:

| | | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|---|
| I | FITIMI NETO PARA TATIMIT | 71,776,921 | 60,806,085 |
| II | SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+) | 5,780,621 | 3,400,202 |
| 1 | Amortizime tej normave fiskale | - | - |
| 2 | Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor | - | - |
| 3 | Gjoba,penalitete,demshperblime | 5,780,621 | 3,400,202 |
| 4 | Provizione qe nuk njihen | - | - |
| 5 | Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta | - | - |
| 6 | Te tjera | - | - |
| III | PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-) | - | - |
| IV | FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III) | 77,557,542 | 64,206,287 |
| V | Shpenzimi i tatim fitimit-10% | 7,755,754 | 6,420,629 |
| VI | FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V) | 64,021,167 | 54,385,456 |



REPUBLIKA E SHQIPERISE IMPOKTI I TVSH G.P.G CO SH.P.K NIPT:J64224443V LUSHNJE ALBANIA

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**
**Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011**
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Si shpenzime te pazbriteshme jane perfshire gjoba e penalitete tatimore, materiale, paga te pakaluara ne banke,jane konsideruar edhe interesat bankare te ushtrimit per shkak te tejkalimit te plote te huase krahasuar me katerfishin e kapitaleve te veta.

**13. Transaksione te paleve te lidhura**

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , ne 31 dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

**14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.
Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise,. Raportet e rentabilitetit per vitin 2012 jane: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare (intresave) 9.38 %, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 8.3 %.

**15. Shifrat krahasuese**

Shifrat krahasuese te deklaruara ne pasqyrat financiare 2012 jane te krahasueshme me deklarimet ne pasqyrave financiare te vitit 2011, te cilat jane ndertuar sipas SNK-ve .

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import & Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J61324443V LUSHNJE ALBANIA

**XHEVDET** HYSENI Lagja nr.4, Rr. Migjeni, përballe Shkollës Jusuf Puka Kati i dytë Durrës

**EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR** Tel: 0355 52 220022, cel: 0692041504, email: financaxhh@hotmail.com

## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

*Mbi pasqyrat financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2012*

**Drejtuar: Ortakut te vetem të shoqerisë "G.P.G COPANY" shpk**

Adresa: Lagja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondes se Plukut, Lushnje

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "G.P.G. COMPANY" shpk (më poshtë Shoqëria), te cilat përfshinë pasqyrën e pozicionit fananciar të datës 31 Dhjetor 2012, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera shpjeguese.

***Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare***

Drejtimi është përgjegjës për pregatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiere në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto përgjegjësi përfshijne: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, të përshtatshëm për pregatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare , që nuk përmbajnë anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, përzgjedhja dhe zbatimi i politikave të përshtatshme kontabël, dhe kryerja e cmuarjeve kontabël të arsyeshme për këto rrethana.

***Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur***

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Unë bëra auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojme kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë sigurinë e arsyeshme, që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve të dhena në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë ketu edhe vleresimin e rreziqeve të anomalive material në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlereson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të shoqërisë mbi pregatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm te shoqerise. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmerinë e cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionit tim të auditimit.

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
XHEVDET HYSENI
Durres-ALBANIA

**XHEVDET** HYSENI

**EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR**

Lagja nr.4, Rr. Migjeni, përballe Shkollës Jusuf Puka Kati i dytë Durrës

Tel: 0355 52 220022, cel: 0692041504, email: financaxhh@hotmail.com

***Opinion***

**Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "G.P.G. COMPANY" shpk në datën 31 Dhjetor 2012, performancën e saj financiare dhe fluksin e parasë për vitin e mbyllur ne këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit.**

**Ekspert Kontabël i Rregjistruar**

**Xhevdet HYSENI**

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
XHEVDET HYSENI
Durres-ALBANIA
Liç. Nr. 295

Lagja nr.4, Rr. Migjeni, përballë Shkollës
Jusuf Puka Kati i dyte Durres

Durrës me 29.03.2013